



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 1958/Prot.
3

Tiranë, më 07.03 2025

**Të dhëna mbi Vendimin
Nr. 02, datë 20.01.2025**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave, me Vendimin Nr. 02, datë 20.01.2025 ka vendosur të përjashtojë për 12 (dymbëdhjetë) muaj operatorin ekonomik "Lel-Medical" Shpk, me NIPT K81917006T nga e drejta për të fituar kontrata publike, për paraqitje dokumentacioni me të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në procedurat e prokurimit.

1. Arsyet e heqjes së emrit të operatorit ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike

Kundër këtij vendimi "Lel-Medical" i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke i kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë, si dhe pezullimin e efekteve të vendimit të APP Nr. 02/2025.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. Regj. Them 47 (300004-01111-80-2025), datë regj 03.02.2025, datë vendimi 07.02.2025 (protokolluar në institucion me Nr. 1958 Prot., datë 07.03.2025), ka vendosur pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë, si dhe pezullimin e zbatimit të vendimit të APP Nr. 02/2025, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Në nenin 510/a të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: "*Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm*".

Në këto kushte, në mbështetje të nenit 510/a të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të nenit 180, pika 1, gërma "b" të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", APP ka vijuar duke proceduar me heqjen e emrit të këtij operatori ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në faqen zyrtare të APP. Ky vendim qëndron në fuqi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.